

AKTIVITETI KËRKIMOR I DEPARTAMENTIT TE INDUSTRIVE KREATIVE

Departamenti i Industriëve Kreative përfaqëson një qendër kërkimore të dedikuar për zhvillimin e zgjidhjeve të aplikuara në fushën e dizajnit dhe mediave kreative. Gjatë viteve të fundit, departamenti ka zhvilluar kërkime të thella përmes projektit Erasmus+ Digitcreshe, i cili u mbyll me sukses dhe produkte konkrete të cilat përfshijnë një platformë online për mësimin dhe integrimin e metodave të gamifikimit në akademi. Kërkimi shkencor është realizuar përmes dy laboratoreve kërkimore të pajisura në mënyrë strategjike: Creative Maker Space, i dedikuar për prototipizim dhe prodhim të produkteve përmes teknologjive (3D printing, CNC, dhe të tjera), dhe Vitamina Multimedia Lab, i fokusuar në prodhimin e përmbajtjeve dhe përvojave interaktive. Departamenti ka dhënë kontribut të rëndësishëm në Trienalen e Arkitekturës të Tiranës, rezultat i të cilit ishte publikimi i një libri. Këtë vëllim kërkimor, departamenti synon të zgjerojë dhe të thellojë nëpërmjet programeve të reja në game design, media interaktive, dizajn grafik, si dhe në dizajn dhe prototipizim të produkteve.

INFRASTRUKTURA KËRKIMORE

Laboratorët Ekzistues

Creative Maker Space

Laboratori i Creative Maker Space është një punishte prodhimi e dedikuar për kërkimin e aplikuar në ndërtimin e protipeve dhe produkteve. Ai është i pajisur me makineri avangarde: 3 printera 3D (FDM), një printer 3D për rezin, makinë CNC për prerje dhe frëzim, makinë Formbox për vakum-formim, presa tipografike, dhe mjete të tjera të specializuara. Ky laborator shërben si një fokus kritik për zhvillimin e zgjidhjeve inovative në fushën e dizajnit të produkteve dhe arkitekturës parametrike, duke mbështetur kërkime në materialet e qëndrueshme dhe teknologjitë e fabrikimit dixhital.

Vitamina Multimedia Lab

Vitamina Multimedia Lab është e dedikuar për kërkimin në media interaktive dhe përmbajtjes vizuale. Laboratori përfshin: studio fotografike të plotë, studio podcast, kompjutera të konfiguruar për modelim 3D dhe vizualizim, kamerat fotografike profesionale, dronin për fotografim ajror, dhe pajisje VR për zhvillimin e përvojave interaktive. Përmes këtij laborator, departamenti ka mbështetur prodhimin e podcasteve studentore dhe realizimin e dy përvojave VR inovative: Berat Ethnographic Museum (projekt i plotësuar dhe i lançuar) dhe Tirana Architecture History Museum (në fazën e prototipizimit). Bashkëpunimi për Berat Ethnographic Museum u realizua në partneritet me Departamentin e Shkencave të Aplikuara.

Infrastruktura e Nevojshme për Zhvillimin e Mëtejshëm

Departamenti ndeshet aktualisht me kufizime kapaciteti në infrastrukturën e prodhimit, ku printerët janë jashtë shërbimi dhe kërkimet në zhvillim presin për resurse shtesë. Në perspektivën e zgjerimit në programe të reja—dizajn lojërash, media interaktive, dizajn grafik, dhe dizajn i mobilijeve—departamenti ka nevojë për investime strategjike në infrastrukturën e ardhshme:

1. Kapaciteti i Prodhimit: Zëvendësimi dhe zgjerimi i pajisjeve për printim 3D (printues FDM dhe SLA me saktësi dhe shpejtësi të lartë), makinë prerëse Lazer, dhe sisteme printimi të specifikuara për dizajnin grafik (printer plotter, printer & cutter për dizajn paketimesh)

2. Zhvillimi i Lojërave dhe Mediave Interaktive: Stacione pune me performancë të lartë për modelim 3D në kohë reale, licenca për motorë zhvillimi (Unity, Unreal Engine), software për animacione, sisteme 'motion capture' për animacion të avancuar.

3. Dizajn i Mobilijeve: Laborator i plotë për testim të materialeve, makineri për përfundim (sanding, varnish, upholstery tools), inventar të gjërë i materialeve konstruktive dhe tekstilësh, dhe zona për prototipe në shkallë 1:1.

4. Infrastruktura Suport: Zgjerim i hapësirës fizike të laboreve për të akomoduar pajisjet e reja dhe për të kryer kërkimet paralelisht.

Këto investime do të përfortin kapacitetin kërkimor të departamentit dhe do të pozicionojnë institucionin si qendër lëvizëse në kërkimin e aplikuar brenda sektorit të industrive kreative.